



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE
DREJTORIA E POLITIKAVE TE PESHKIMIT

Nr. 280 te Prot

R R E G U L L O R E

(Nr. 2, Date 17. 5.2007)

PER

LIÇENSIMIN E PESHKIMIT DHE TE AKUAKULTURES

Ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4, te Kushtetutes dhe te germave “ë” dhe “i” te nenit 32 te Ligjit nr. 7908 date 5.4.1995 “Për Peshkimin dhe Akuakulturën”, i ndryshuar, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave miraton Rregulloren si me poshte:

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Qellimi

Kjo rregullore synon zbatimin e dispozitave te ligjit nr. 7908 date 5.4.1995 “Për Peshkimin dhe Akuakulturën”, i ndryshuar, sidomos te dispozitave te nenit 32 te tij, duke percaktuar rregullat, procedurat e afatet per kerkimin e licensave, shqyrtimin e kerkeses e te dokumentacionit qe e shoqeron dhe miratimin e saj.

Neni 2

Perkufizime

I. I. Ne kuptim te kesaj rregulloreje:

1. **Anije peshkimi** eshte cfaredo lloj anijeje e pajisur per peshkimin industrial te burimeve ujore te gjalla, duke përfshirë anijet mbështetëse dhe çdo anije tjetër të përfshirë në veprimtarinë e peshkimit;
2. **Autoriteti i menaxhimit te peshkimit** eshte Ministria, e caktuar me ligj per te kryer funksionet e menaxhimit te peshkimit.
3. **Drejtor e drejtori** jane respektivisht drejtori dhe drejtorja e politikave te peshkimit ne Ministrine e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave;
4. **Kontroli** eshte nje inspektim i planifikuar ose jo, i ushtruar nga Inspektorati i Peshkimit, i cili ka per qellim:

- a) verifikimin e perputhshmerise se veprimtarise qe kontrollohet, me kerkesat e legjislacionit te peshkimit,
 - b) monitorimin e aktiviteve te licensuara, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne licensen e miratuar.
5. **Licence per anije peshkimi** eshte dokumenti qe miratohet nga Ministri, per te kryer nje aktivitet konkret peshkimi me nje anije te caktuar, ne kushte te percaktuara, ku certifikohen minimalisht te dhenat sipas Aneksit 6, lidhur me identifikimin e karakteristikave teknike dhe te ndertimit te anijes.
 6. **Licence per aktivitetin e peshkimit dhe akuakultures** eshte dokumenti qe miratohet nga Ministri, ku percaktohen kushtet dhe rrethanat detyrimisht te zbatueshme, ne afatin e percaktuar shprehimisht ne te.
 7. **Ligj** kuptohet ligji nr.7908 date 5.4.1995 "Per peshkimin dhe akuakulturen" i ndryshuar.
 8. **Monitorimi** eshte procesi qe permbledh teresine e vezhgimeve e vrojtimeve mbi zhvillimin e aktivitetit te peshkimit. Monitorimi eshte kerkese e vazhdueshme per marrjen e te dhenave te zenieve, te perberjes llojore, te sforcos se peshkimit, te flakjeve ne det, te zonave dhe sezoneve te peshkimit. Monitorimi perfshin gjithashtu regjistrimin dhe mbajtjen e ketyre te dhenave qe jane objekt i analizave dhe prognozave.
 9. **Organizate** kuptohet Organizata e Menaxhimit te Peshkimit, e krijuar sipas nenit 26 te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise dhe te nenit 31/1 te Ligjit Nr 8870 date 21.03.2002 "Per ushtrimin e veprimtarise ne sektorin e peshkimit".
 10. **Pajisje peshkimi** kuptohen gjithe ato pajisje te destinuara per zenien e organizmave ujore;
 11. **Peshkim artizanal** kupton format e peshkimit profesional me mjete fikse ose te levizshme si grepat (parangallet), mrezhat, njicat stavnik, bilanxh etj., qe ushtrohen ne ujera bregdetare dhe ujra te brendshme;
 12. **Peshkim fundor** (demersal) kuptohet peshkimi i organizmave ujore qe jetojne ne tabanin e ujerave. Ky peshkim realizohet me rrjeta qe terhiqen me nje shpejtesi te caktuar mbi tabanin e ujerave me ane te fuqise motorike;
 13. **Peshkim industrial** kuptohen format e peshkimit profesional fundor, pelagjik dhe me rrethime;
 14. **Peshkim me mjete fikse ose stacionare** kuptohet peshkimi me cdo lloj paisje (rrjete, kallam ose tub plastik a metalik i thurur etj) e fiksuar e vendosur per zenien e organizmave ujore si psh dajlane, prita, bilanxhe, stavnike etj ;
 15. **Peshkim pelagjik** kuptohet peshkimi i llojeve te peshqeve qe jetojne ne shtresen ujore ndermjet fundit dhe siperfaqes, qofshin keta te vegjel apo te medhenj (sardela, acuga, toni etj);
 16. **Peshkim profesional** kuptohet aktiviteti i peshkimit qe kryhet per qellime ekonomike dhe fitimi.
 17. **Peshkim me rrethim** kuptohet peshkimi i llojeve te ndryshme te peshqeve me rrjeta qe mundesojne rrethimin e tufave, (sardele, acuge) te grumbulluara per shkaqe biologjike ose jo.
 18. **Peshkim sportiv** kuptohet aktiviteti i peshkimit qe kryhet per qellime defrimi, shlodhese ose sportive dhe pa qellim fitimi.
 19. **Port Peshkimi** kuptohet nje port, liman i vecante peshkimi ose zone e caktuar brenda nje porti tregtar, ne te cilin ofrohen sherbimet per anijet e peshkimit, se bashku me akuatoriumin, bankinat, territorin tokesor, ndertesat dhe strukturat perkatese.

20. **Qender Peshkimi** kuptohet nje mol, ure ne det ose valprites, ne lagune ose liqen qe perdoret per qellime peshkimi se bashku me territorin tokesor, ndertesat dhe stukturat perkatese.
21. **Speciet objekt peshkimi (target)** kuptohen speciet kryesore qe duhet te zihen nga nje anije ose nje mjet ne nje forme peshkimi te caktuar. Ne peshkimin pelagjik me koshilok kjo mund te jete vetem nje specie (psh sardela), ndersa ne peshkimin me koca mund te jete nje grup speciesh (psh merluci, barbuni, gjuheza etj).
22. **Stavnik** kuptohet instalimi i rrjetave i perbere nga nje krah pengues, i cili e drejton peshkun ne nje seri dhomash konike ose ne forme piramide gjithmone e me te vogla, deri te thesi i grumbullimit. Stavniku mund te jete me shtylla ose spiranca, montohet ne ujra pak te thella, ne laguna, lumenj dhe ne afersi te bregut
23. **Tonazh** kuptohet tonazhi bruto i percaktuar nga Aneksi I i Konventes Nderkombetare mbi tonazhin e anijeve 1969. Tonazhi bruto percaktohet me ane te formule $GT=K_1V$ ku V eshte Volumi total i hapësirave te mbyllura te anijes ne meter kub dhe $K_1=0.02+0.02\log_{10}V$
24. **Ujera te brendshme** perfshihen lagunat bregdetare, liqenet natyrore, liqenet e hidrocentraleve, ujembledhesit e bujqesise, lumenjte dhe ujera te tjera te Republikes se Shqiperise te ndryshme nga ujerat detare ;
25. **Ujera territoriale** jane ujerat e zones detare ne te cilat shteti bregdetar ushtron sovranitet te plote. Zona e ujerave territoriale shtrihet deri ne 12 milje detare largesi nga vija e zbatices te bregut te detit. Ky perkufizim eshte percaktuar nga Konferenca e Kombeve te Bashkuara per Ligjin mbi Detin (UNCLOS), i cili parashikon edhe rregulloret dhe menaxhimin e gjithe burimeve te gjalla si edhe percaktimin e Zones Ekonomike Ekskluzive (EEZ).

II. Ne kuptim te kesaj rregulloreje :

Inicialet e perdorura ne formularet statistikore te paraqitur ne anekset bashkelidhur rregullores shprehin :

1. SD (statistikat ditore te peshkimit detar)
2. SB (statistikat ditore te peshkimit ne ujrata e brendshme)
3. SM (statistikat ditore te moluskeve bivalve)
4. SV (statistikat vjetore te peshkimit dhe akuakultures)

KREU II

KERKESA DHE DOKUMENTACIONI PER APLIKIM

Neni 3

Llojet e licencave te peshkimit dhe akuakultures

1. Ne peshkimin detar me mjete lundruese me kuverte, motobarka ose anije peshkimi, licenca jepet per cdo mjet lundrimi te vecante.
2. Ne peshkimin bregdetar, si dhe ne ujera te brendshme me mjete lundruese pa kuverte (sanalle, lundra etj., me ose pa motor), licenca jepet per nje ose disa mjete lundruese, duke specifikuar numrin e tyre.
3. Ne peshkimin me mjete fikse ose stacionare si dhe ne grumbullimin e molusqeve ne bregdet ose laguna, licenca jepet per cdo mjet stacionar te instaluar.

4. Ne veprimtarine e akuakultures, licenca jepet per cdo njesi prodhimi te vecante (ekonomi per prodhimin e peshqve, te krustaceve, te moluskeve ose te te vegjelve te tyre), te ndertuara ne toke ose te instaluara ne ujera te brendshme dhe ne det.
5. Ne peshkimin sportiv, licenca jepet vetem per shoqatat e regjistruara per kete qellim.

Neni 4

Kerkesa per license peshkimi detar me mjete lundruese me kuverte

1. Subjekti qe kerkon te pajiset me licence per peshkimi detar me mjete lundruese me kuverte, paraqet kerkesen per licence, sipas modelit KP1 qe ndodhet ne aneksin 1 te kesaj rregulloreje.
2. Kerkesa shoqerohet me dokumentat si me poshte:
 - a) vendimi i regjistrimit ne gjykate (origjinal ose i noteruar);
 - b) deshmi e regjistrimit te anijes (deshmia e pronesise dhe deshmia e flamurit) te leshuara nga Kapiteneria e Porteve (origjinale ose te noteruara);
 - c) certifikate e lundrimit leshuar nga Regjistri Detar (origjinale ose e noteruar);
 - d) miratimin e OMP per perdorimin e portit te peshkimit per ankorim te anijes (origjinale ose e noteruar);.

Neni 5

Kerkesa per license peshkimi bregdetar me mjete lundruese pa kuverte

1. Subjekti qe kerkon te pajiset me licence per peshkimi detar me mjete lundruese pa kuverte, paraqet kerkesen per licence, sipas modelit KP1 qe ndodhet ne aneksin 1 te kesaj rregulloreje.
2. Kerkesa shoqerohet me dokumentat si me poshte:
 - a) vendimi i regjistrimit ne gjykate te subjektit te peshkimit (origjinal ose i noteruar);
 - b) dokumentin e regjistrimit te mjetit lundrues (lunder, varke, sanall) nga policia kufitare e rrethit ku do zhvillohet aktiviteti (origjinale ose e noteruar),
 - c) fotokopje e noteruar e librit te anijes te kapitenerise se porteve, i vlefshem per periudhen qe do ushtrohet aktiviteti i peshkimit.

Neni 6

Kerkesa per license peshkimi ne ujerat e brendshme

1. Kerkesa per license peshkimi ne ujerat e brendshme hartohet sipas modelit KP1 qe ndodhet ne aneksin 1 te kesaj rregulloreje
2. Kerkesa shoqerohet me dokumentat si me poshte:
 - a. vendimi i regjistrimit ne gjykate te subjektit te peshkimit (origjinal ose i noteruar);
 - b. per ujembledhesit e bujqesise paraqitet kontrata me SHPU, te ciles i eshte transferuar ujembledhesi ose miratimi nga ShPU. Ne rast se ujembledhesi nuk eshte ne administrim te SHPU- ve, paraqitet miratimi nga organi qe e ka ne administrim.
 - c. per ujembledhesit e bujqesise paraqitet gjithashtu harta me pershkrimet e karakteristikave te ujembledhesit (siperfaqja, volumi i ujit, pozicionimi)

- d. per kategorite ujore ku jane formuar OMP-te, mund te aplikohet per nje licence te vetme ne emer te OMP. Ne kete rast pervec kerkeses, paraqitet edhe lista e anetareve te OMP.

Neni 7

Kerkesa per license peshkimi me mjete fikse ose stacionare si dhe per grumbullimin e molusqeve ne bregdet ose laguna

1. Kerkesa per license peshkimi me mjete fikse ose stacionare si dhe per grumbullimin e molusqeve ne bregdet ose laguna, hartohet sipas modelit KP1 qe ndodhet ne aneksin 1 te kesaj rregulloreje
2. Kerkesa shoqerohet me dokumentat si me poshte :
 - a) vendimi i regjistrimit ne gjykate te subjektit te peshkimit (origjinal ose i noteruar);
 - b) ne se ka mjet lundrues, dokumentin e regjistrimit te mjetit lundrues (lunder, varke, sanall) nga policia kufitare e rrethit ku zhvillohet aktiviteti.(origjinal ose i noteruar).
 - c) per dajlanet e lagunave paraqitet projekti qe do zbatoje kerkuesi ne te cilin trajtohen investimet qe do kryhen per mirembajtjen e grykes se komunikimit me detin, per zhvillimin e dajlanit, si dhe per punesimin e peshkatareve.

Neni 8

Kerkesa per license akuakulture

1. Subjekti qe kerkon te pajiset me licence per akuakulturen harton kerkesen sipas formularit KA1 qe ndodhet ne aneksin 3 te kesaj rregulloreje.
2. Subjekti aplikon njeherazi si per t'u pajisur me leje mjedisore edhe per licence akuakulture.
3. Pervec dokumentacionit qe kerkohet per leje mjedisore, ne dosje paraqitet edhe gentplani i ekonomise se peshkut

Neni 9

Kerkesa per license peshkimi sportiv

1. Kerkesa per t'u pajisur me licence per peshkim sportiv hartohet sipas formularit KPS qe ndodhet ne aneksin 10 te kesaj rregulloreje.
2. Kerkesa paraqitet vetem nga shoqata te peshkatareve sportive dhe shoqerohet me dokumentat si me poshte:
 - a) vendim i regjistrimit ne gjykate si person juridik me objekt peshkimin sportiv. (origjinal ose i noteruar)
 - b) dokumenti i regjistrimit nga policia kufitare te cdo mjeti lundrues qe do te perdoret apo qe zoteron shoqata. (origjinal ose i noteruar)

- c) fotokopjen e noteruar te deshmise se aftesise te lundrimin per mjetet e voga te Kapitenerise se Portit per mjetin apo mjetet lundruese te shoqates. Deshmia duhet te jete brenda afatit te vlefshmerise.
2. Licenca e peshkimit sportiv, mund te autorizojte perdorimin e me shume se nje mjeti lundrues te lejuar ne ushtrimin e ketij aktiviteti. Ne kete rast, ne licence specifikohet :
- a) numri maksimal i mjeteve lundruese te autorizuar per zhvillimin e kesaj veprimtarie;
 - b) numri maksimal i diteve te peshkimit qe do te ushtroje secili mjet lundrues gjate nje viti;
 - c) numri maksimal i personave qe do te imbarkojte cdo mjet lundrues gjate ushtrimin te peshkimit sportiv.

Neni 10 **Rinovimi i licences**

1. Rinovimi i licences behet me kerkese te subjekteve te peshkimit jo me vone se nje muaj para perfundimit te afatit te licences ekzistuese.
2. Subjekti qe nuk e paraqit kerkesen brenda afatit te theksuar ne piken 1 te ketij neni humb te drejten e rinovimit dhe paraqet kerkesen e pergatit dokumentat per license te re.
3. Per te rinovuar licencen e peshkimit, paraqiten keto dokumenta :
 - a) kerkesa per rinovimin e licences (sipas formularit ne anekset 2 dhe 11);
 - b) formulari me te dhenat statistikore, sipas anekseve 18-23, mbi aktivitetin e peshkimit dhe zbatimin e kushteve te licences ekzistuese.
 - c) mendimi me shkrim i inspektorit te peshkimit te zones qe tregon si i ka zbatuar subjekti kerkesat e licences dhe legjislacionin e peshkimit.
4. Per ujembledhesit e bujqesise, paraqitet pervec dokumentave te pikes 3 te ketij neni, edhe dokumenti per ripopullimin me rasate per cdo vit.

Neni 11 **Transferimi i licences**

1. Transferimi i licences kryhet:
 - a) Per cdo subjekt qe behet pronar ose perfaqesues ligjor i nje mjeti lundrues peshkimi, apo i nje impianti akuakulture te pajisur me licence dhe qe subjekti deshiron te vazhdoje ushtrimin e veprimtarise sipas licences ekzistuese.
 - b) Per cdo subjekt, pronar te nje mjeti lundrues me kuverte, te pajisur me licence per peshkimin profesional, i cili kerkon transferimin e licences ne nje mjet tjeter lundrues peshkimi, me karakteristika te ngjashme teknike kur mjeti i meparshem ka dale jashte perdorimit per peshkim, duke e vertetuar kete me dokumentacionin e nevojshem.

2. Procedura e transferimit te licences eshte e njejte me ate te licensimit, e percaktuar ne kete rregullore.
3. Kerkesa per transferim shoqerohet me dokumentat si me poshte:
 - a) dokumenti ligjor qe verteton ndryshimin e perberjes se shoqerise ose rregjistrimin e ri te shoqerise ne gjykate. (dokumenti origjinal ose i noteruar)
 - b) aktin noterial te kalimit ne pronesi : shitblerje, dhurim, trashegimi, vendim te asamblese se ortakeve etj. (dokumenti origjinal ose i noteruar)
 - c) dokumentacionin nga organet e tjera shteterore (kapiteneri e porteve, polici kufitare etj) qe reflekton ndryshimet e bera. (dokumentacioni origjinal ose i noteruar)
4. Kerkesa per transferim paraqitet brenda 1 muaji nga ndodhja e ndryshimeve te pershkruara ne piken 1 te ketij neni.
5. Kur Bordi shprehet dakort per transferimin e licenses, Drejtori leshon nje dublikate licence, pa ndryshuar numrin e licences se meparshme.

KREU III

PROCEDURA E LICENSIMIT

Neni 12

Dosja

Kerkesa se bashku me dokumentat qe e shoqerojne, sistemohet ne nje dosje, e cila permban edhe:

- a. listen e dokumentave;
- b. faturen qe deshmon pagimin e tarifese;
- c. mendimin e inspektorit te peshkimit per veprimtarine qe kerkon te licensohet.

Neni 13

Paraqitja e dokumentave

1. Kerkesa per pajisjen me licence, per rinovimin ose per transferimin e saj dhe dublikaten e licenses, e shoqeruar me dokumentat perkatese, paraqiten per shqyrtim dhe miratim ne ministri, duke u regjistruar ne protokoll.
2. Dokumentat shqyrtohen jo me vone se nje 15 dite nga data e rregjistrimit ne protokoll.
3. Kur kerkuesit i del nevoja te bej ndryshime apo plotesime ne dokumentat e dosjes qe kane te bejne me te dhenat teknike te mjetit, te impiantit, te instalimit, te percaktimit te sakte te kufijve apo te listes se peshkatareve te punesuar nga subjekti, ato merren parasysh vetem kur dorezohen para shqyrtimit te dosjes. Ne se kerkuesi nuk arrin ti plotesoje dokumentat brenda kesaj kohe, afati i shqyrtimit llogaritet nga dita qe dorezohet dokumenti i fundit.

Neni 14

Veprimet pergatitore te Drejtorise se Politikave te Peshkimit

Ne funksion te pergatitjes se mbledhjeve te Bordit, drejtori cakton nje specialist te drejtorise, i cili:

- a) grumbullon e sistemon dosjet e ardhura dhe, pasi verifikon nese ka detyrime te pashlyera ligjore te subjekteve kerkues ose mjetit lundrues, i paraqet ato per shqyrtim ne mbledhjen e radhes se bordit, sipas aneksit 17 te kesaj rregullore.
- b) harton listen e kerkesave qe do te shqyrtohen ne mbledhjen e radhes. Listimi i dosjeve behet sipas numrit te protokollit qe kane kerkesat;
- c) per rinovimet, relatton edhe per plotesimin e kushteve shtese nese ka, sipas licences se dhene per zhvillimin e aktivitetit.
- d) njofton subjektin te plotesoje dosjen kur ajo ka mungesa, duke i specifikuar cfare mungon.

Neni 15

Bordi i shqyrtimit te kerkesave

Bordi i licencave perbehet nga jo me pak se 5 anetare, specialiste te Ministrise dhe kryesohet nga Drejtori. Perberja e Bordit miratohet me urdher te vecante te Ministrit.

Neni 16

Detyrat e Bordit

1. Bordi ka per detyre shqyrtimin dhe vleresimin e kerkesave per t'u pajisur me License peshkimi dhe te akuakultures, te paraqitura nga persona juridike dhe fizike, vendas apo te huaj per veprimtarite e peshkimit qe kerkohet te ushtrohet.
2. Ne gjithe veprimtarine e tij, Bordi siguron zbatimin e perpikthe te kerkesave ligjore, teknike, si dhe te procedurave e te rregullave te vendosura per tu pajisur me license peshkimi.
3. Per veprimtarine qe kryen, Bordi pergjigjet para Ministrit.

Neni 17

Mbledhjet e Bordit

1. Mbledhjet e Bordit jane te vlefshme kur ne to marrin pjese te pakten 3 anetare.
2. Bordi mblidhet javen e pare dhe te trete te cdo muaji.
3. Per raste te vecanta qe diktohen nga nevojat e punes, Drejtori mund te therrase Bordin ne mbledhje jashte radhe.

Neni 18

Procedura e shqyrtimit te kerkesave

1. Anetaret e Bordit studiojne cdo kerkese individualisht para mbledhjes se Bordit dhe formojne gjykimin e vet, te cilin e parashtrojne ne mbledhje.
2. Bordi shqyrton vecmas cdo kerkese, sipas radhes se regjistruar ne protokoll.

3. Bordi vendos per miratimin e publikatave e te transferimit te licenses.
4. Ne mbledhje, anetaret e Bordit jane te barabarte
5. Per cdo kerkese te shqyrtuar ne mbledhje, Bordi e formon mendimin e tij me konsensus. Ne rast se nje gje e tille nuk arrihet, vendimi merret me shumice te thjeshte dhe ne procesverbal shenohet edhe mendimi i pakices.

Neni 19

Perfundimi i shqyrtimit

1. Pas shqyrtimit te kerkesave, propozimet e dhena gjate mbledhjes se Bordit per secilen kerkese, hartohet proces-verbali nga specialisti i caktuar per kete detyre.
2. Proces-verbali nenshkruhet nga te gjithe anetaret e pranishem ne mbledhjen e Bordit dhe i paraqitet Ministrit per miratim, brenda 2 diteve nga dita e mbledhjes.
3. Proces-verbali hartohet ne dy kopje nga te cilat nje shkon ne protokoll, ne perberje te dosjes qe pasqyron mbledhjen e Bordit dhe nje ne Drejtorine e Politikave te Peshkimit.
3. Çdo anetar ka te drejte te njihet me procesverbalin dhe te kerkoje pasqyrimin e drejte e te plote te mendimeve qe ka shprehur ne mbledhje.

Neni 20

Paraqitja per miratim

1. Ne perfundim te shqyrtimit te kerkesave, Drejtori qe perfaqeson mendimin e Bordit, mbeshtetur ne procesverbalin e mbledhjes, i paraqet per miratim Ministrit:
 - a) **miratimin e licenses se kerkuar, te rinovimit te licenses ekzistuese ose te transferimit te licenses.** Ne kete rast, kerkuesi njoftohet te terheqe Licencen.
 - b) **refuzimin e miratimit, te rinovimit ose te transferimit te licenses.** Ne kete rast, kerkuesi njoftohet me shkrim nga Drejtori, duke i dhene edhe argumentat e refuzimit. Kerkesa e refuzuar mund te riparaqitet pas nje viti.
 - c) **rishqyrtimin e kerkeses.** Ne kete rast, kerkuesi njoftohet per rishqyrtimin si edhe per verifikimet qe do te behen, si kqyrje ne vend, marrje mendimi nga eksperte, nga kryetaret e OMP-ve, mendimin e komunitetit etj, per te garantuar nje mendim te qarte dhe te sakte ne dhenien e vendimit perfundimtar. Rishqyrtimi behet ne mbledhjen pasardhese te Bordit.
2. Per licensat qe u jepen OMP-ve, Drejtori mund te leshoje publikate license per anetarin e OMP-se, sipas listes se paraqitur prej saj.

Neni 21

Mbyllja e procedures

Brenda 3 diteve pasi Ministri ka miratuar licensat e peshkimit dhe te akuakultures, Drejtoria:

1. Njofton kerkuesit dhe OMP-te kur jane kerkues, te paguajne taksen e licenses, te sjellin faturen dhe te marrin licencen e miratuar. Licensa mund te dergohet edhe me poste ne se dergohet fatura e takses se licenses;
2. Njofton subjektet, kerkesat e te cileve nuk jane miratuar, duke qartësuar arsyet, si dhe ç'duhet te bejne ne te ardhmen;
3. Njofton Inspektoret per licensat e miratuara ne zonen qe ata mbulojne.
4. Sistemon materialet e mbledhjes se Bordit dhe i dorezon ne Arkiv, brenda 10 diteve.
5. Perditson Rregjistrin e Licencave te Peshkimit dhe Akuakultures me te dhenat e nevojshme. Formati i rregjistrimit miratohet nga Ministri.

Neni 22

Tarifa e sherbimit

Per te gjitha kerkesat per licensim, rinovim, transferim apo dublikate license, kerkuesi paguan nje tarife sherbimi. Tarifa e sherbimit paguhet ne momentin e dorezimit te kerkeses dhe eshte e pakthyeshme, pavaresisht nga lloji i vendimit qe do te merret. Vlera e tarifes se sherbimit miratohet me Udhezim te vecante te Ministrit.

Neni 23

Ankimi

Ndaj vendimit te mare per kerkesen qe ka paraqitur, subjekti mund te ankohet ne rruge administrative dhe gjyqesore, sipas dispozitave te Kodit te Procedurave Administrative.

Neni 24

Dublikata e licenses

Ne rast se licenca humbet ose behet e pa lexueshme, me kerkese te argumentuar te subjektit, drejtori pergatit nje dublikate nga kopja qe mbahet e arshivuar ne drejtori.

Neni 25

Afatet e licencave

I. Licencat e peshkimit dhe te akuakultures, jane te vlefshme ne afatet si me poshte:

1. Ne peshkimit detar qe ushtrohet me mjete lundruese me kuverte (motobarka ose anije peshkimi), licensa eshte e vlefshme per 5 vjet.
2. Ne peshkimit bregdetar, qe ushtrohet me mjete lundruese pa kuverte (sanalle, lundra etj., me ose pa motor), licensa eshte e vlefshme deri ne 2 vjet.
3. Ne ujembledhesit e bujqesise, licensa eshte e vlefshme deri ne 5 vjet.
4. Ne lagunat bregdetare, ne dajlane, licensa eshte e vlefshme deri ne 10 vjet.
5. Ne lagunat bregdetare me sanalla, licensa eshte e vlefshme deri ne 5 vjet.
6. Ne liqenet dhe lumenj, licensa eshte e vlefshme deri ne 5 vjet.

7. Per molusqet bivalvoret, licenca eshte e vlefshme deri ne 3 vjet.
 8. Per akuakulturen ne det, licenca eshte e vlefshme deri ne 10 vjet.
 9. Per akuakulturen tradicionale me vaska ne toke, licenca eshte e vlefshme deri ne 20 vjet,
- II. Per licensat e akuakultures afati konkret i licenses vendoset ne vartesi te dokumentit te pronesise, te afatit te kontrates se qerese per siperfaqen ku do ushtrohet ky aktivitet, si dhe te sasise se investimeve qe do te kryej subjekti.
- III. Afati konkret fiksohet nga Bordi dhe saktosohet ne licensen qe i jepet ministrit per nenshkrim

Neni 26 **Qendrimet ndaj Licenses**

1. Licenca per ushtrimin e peshkimit apo te akuakultures, miratohet, ndryshohet, pezullohet, shpallet e pavlefshme ose hiqet nga ministri dhe vetem ne kushtet e parashikuara me ligj e me aktet nenligjore ne zbatim te tij.
2. Per zbatimin e kerkesave te pikes 1 te ketij neni, ministri vendos mbi bazen e propozimit me shkrim te Drejtorit te Politikave te Peshkimit qe perfaqeson mendimin e Bordit te licensave ose te Komisionit te Shqyrtimit te Kundravajtjeve Administrative ne fushen e peshkimit e te akuakultures.

Neni 27 **Ndryshimi i licenses**

1. Ndryshimi i licenses nenkupton:
 - a) ndryshime te llojit te saj ne raport me veprimtarine per te cilen jepet;
 - b) ndryshime te pjeseshme te kushteve e te kerkesave te saj;
 - c) ndryshime te afatit te saj;
 - d) ndryshime te subjektit, me rastin e transferimit te saj.
2. Si rregull ndryshimi kerkohet me shkrim nga subjekti, por propozohet edhe nga Drejtori i Politikave te Peshkimit, nga Bordi i licensave ose nga Komisioni i Shqyrtimit te Kundravajtjeve Administrative ne fushen e peshkimit e te akuakultures; te cilet mbeshteten mbi dokumenta e te dhena faktike

Neni 28 **Pezullimi i licences**

1. Licenca pezullohet per nje afat te caktuar, por jo me te gjate se 6 muaj, kur:
 - a) Subjekti fizik apo juridik i licencuar nuk paguan taksen e licenses brenda dates 31 mars te vitit ne vazhdim;
 - b) Mjeti lundrues apo impianti i akuakultures, nuk perdoret per nje periodhe me shume se tre muaj radhazi, per zhvillimin e veprimtarise per te cilen ka marre licence.

- c) Subjekti nuk zbaton detyrimet qe rrjedhin nga kerkesat e kushtet e licences.
- d) Subjekti nuk realizon investimet qe ka marre persiper;

2. Licenca mund te pezullohet edhe kur ka nje propozim te Keshillit Administrativ te OMP ne te cilen subjekti ben pjese.

Neni 29 **Heqja e licenses**

Licenca i hiqet subjektit kur:

- a) subjekti i licencuar, person fizik, vdes ;
- b) subjekti e mbyll veprimtarine per te cilen eshte licensuar;
- c) subjekti i licencuar person juridik prishet, shperbehet, likujdohet me vendim gjyqesor te formes se prere;
- d) subjekti nuk paguan gjobat e vendosura per shkeljet e konstatuara ne baze te neneve 39 dhe 40 te Ligjit;
- e) subjekti eshte ndeshkuar dy here brenda vitit kalendarik nga Komisioni i Shqyrtimit te Kundravajtjeve Administrative per Peshkimin dhe Akuakulturen;
- f) me propozim te Komisionit te Shqyrtimit te Kundravajtjeve Administrative, pas shqyrtimit te kundravajtjeve ne perputhje me dispozitat e nenit 39 të ligjit.
- g) kur nga kontrollat dhe inspektori i zones dokumentohen shkelje te renda te kerkesave te ligjit.
- h) kur provohet me vendim gjykate te formes se prere se subjekti apo administratori i shoqerise, eshte i inkriminuar, apo ka dokumenta zyrtare qe provojne se subjekti e perdor aktivitetin e licencuar per te mbuluar veprime te kundraligjshme te realizuara prej tij.

Neni 30 **Shpallja e pavlefshme**

1. Ministri, e shpall te pavlefshme licensen ne cdo kohe kur provohet se per marrjen e saj subjekti ka paraqitur dokumenta te fallsifikuara ose ka mashtruar ne hartimin e tyre.
2. Per licensen qe shpallet e pavlefshme, njoftohet me shkrim subjekti, organi perkates i qeverisjes vendore, OMP-ja, ne se ekziston, ministrite e linjes qe jane te angazhuara me veprimtarine te ciles i shpallet e pavlefshme licenca

Neni 31 **Detyrimet e subjekteve te peshkimit**

1. Subjekti i pajisur me license peshkimi ose akuakulture:
 - a) zbaton aktet ligjore dhe nenligjore per peshkimin dhe akuakulturen;
 - b) zbaton Rregulloren e Menaxhimit te Portit ose Qendres se Peshkimit;
 - c) mban kurdohere me vete dhe ne anije licensen e peshkimit;
 - d) ploteson me korrektesi kerkesat dhe kushtet e licences se peshkimit;
